



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:115892
Datë: 22.04.2024
Numri i dokumentit: 05601545

CA.nr.3405/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dardan Kadolli, kryetar i kolegjit, Burim Shala dhe Bujar Muzaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit A. R. nga G., të cilin përfaqëson sipas autorizimit H. Sh., avokat në Prishtinë, ndaj të kundërshtares së sigurimit N. P. K. “E.” SH.A, Graçanicë, përfaqësuar nga N. Sh., avokat në Graçanicë, objekti i çështjes caktimi masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së propozuesit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Graçanicë, C.nr.133/23, datë 04.08.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 22.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e propozuesit A. R. nga G., ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë, C.nr.133/23, datë 04.08.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë me aktvendimin e atakuar me numër C.nr.133/23, datë 04.08.2023, ka vendosur: Refuzohet propozimi paditësit-propozuesit A.R. nga Graçanicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokat H.Sh. i parashtruar kundër Ndërmarrjes Publike Komunale “E.” A.D Graçanicë, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit me numër 2070, me datë 15.05.2023, që të obligohet organi kompetent komunal, komisioni komunal i aksionarëve, që të shtyjë ekzekutimin e vendimit me numër 2070 me datë 15.05.2023, deri në aktvendimin përfundimtar të kësaj çështje, si i pa bazuar.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë propozuesi, i cili nuk i ka specifikuar shkaqet ankimore qartësisht, porse nga përshkrimi në ankesë, ai e ka goditur vendimin e shkallës së parë për shkak të gjendjes faktike dhe shkelje të dispozitave procedurale. I ka propozues gjykatës që vendimi i goditur të ndryshohet.

Pala kundërshtare e sigurimit ka parashtruar përgjigje në ankesë, duke propozuar të refuzoj si të pa bazuar ankesën dhe të vërtetoj aktvendimin e shkallës së parë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ka vlerësuar se:

- Ankesa e propozuesit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi me datë 24.05.2023, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, më pas ky departament, ishte shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, dhe lënda është dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Graçanicë. Paditësi ka paraqitur se me datë 30.03.2023, është shpallur konkursi publik nga ndërmarrja publike komunale “E.” në Graçanicë për drejtor të bordit e ndërmarrjes. Paditësi kishte aplikuar për këtë pozitë, duke i plotësuar kushtet për këtë pozitë. Nga komisioni ai është njoftuar se nuk ishte përzgjedhur për këtë pozitë, ndonëse ai i pretendonte se i kishte plotësuar kushtet për tu zgjedhur. Sipas tij, publikimi i rezultateve nga Komisioni ka qenë i kundërligjshëm, duke u shkelur parimet bazë të vlerësimit për kandidatë, duke mos shqyrtuar në tërësi përgatitjen profesionale, por përmes diskriminimit dhe kundërligjshmërisë. Për të gjitha këto parregullsi, ai ka parashtruar ankesë. Për sa i përket propozimit për caktimin e masës së sigurimit, ai ka arsyetuar se zbatimi i vendimit të datës 15.05.2023 do t'i sillte dëm të pariparueshëm paditësit, për faktin se do të ishte vështirë të ktheje prapa zbatimin e tij. Ai është thirrur në nenin 22 par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Po ashtu edhe në seancë të dëgjimit sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, ai ka kërkuar të vendoset masa e sigurimit, duke pretenduar se janë plotësuar kushte ligjore për caktimin e saj.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas propozimit të palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit, ka marrë aktvendimin e atakuar, C.nr.133/23, të datës 04.08.2023, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar e propozuesit për caktimin e masës së sigurimit, me përmbajtje sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Në arsyetimin e aktvendimit të atakuar ka cekur se pas analizimit dhe vlerësimit të provave ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse për caktimin e masës së sigurimit në këtë fazë të procedurës është i pa bazuar. Ka cekur se pas hapjes së konkursit dhe vlerësimit të aplikacioneve, komisioni ka kryer intervistat me të gjithë kandidatët, dhe me vendimin me numër 2070/23 i ka emëruar katër anëtarë të bordit të drejtorëve. Gjithashtu është vërtetuar se paditësi ka qenë pjesëmarrës i konkursit, por me vendimin e lartpërmendur nuk është përzgjedhur për pozitën për të cilën ka konkuruar. Gjykata e shkallës së parë më tej ka arsyetuar se për caktimin e masës së propozuar të sigurisë është e nevojshme që në përputhje me dispozitat e LPK-së, në mënyrë kumulative të plotësohen dy kushte, që propozuesi i sigurisë të bëjë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës subjektive dhe nëse ekziston rreziku që pa caktimin e një mase të tillë pala kundërshtare do të mund të vështirësonte apo në mënyrë të konsiderueshme ta vështirësonte realizimin e kërkesës. Paditësi më asnjë provë para gjykatës nuk e ka argumentuar që janë përmbushur

kumulativisht të dy kushtet e përshkruara ligjore për caktimin e masës së sigurisë, të parapara me nenin 297 të LPK-së. Faktet që i përkasin procedurave dhe kushteve të konkursit, sipas gjykatës së shkallës së parë do të vlerësohen gjatë procedurës sipas padisë.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala paditëse me ankesë.

Janë të pabazuara pretendimet ankimore të paditësit-propozuesit se aktvendimi i atakuar është përfshirë me të meta thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyetim të mjaftuar për faktin vendimtar rreth plotësimin të kushteve ligjore për caktimin e masës së sigurimit, dhe në këtë drejtim aktvendimi në fjalë nuk është kundërthënës me përmbajtjen provave të paraqitura ashtu siç theksohet në ankesë.

Gjykata e Apelit në tersi mbështet vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket çështjes së vlerësimit të plotësimin të kushteve në mënyrë komulative për caktimin e masës së sigurisë, ashtu siç është përcaktuar më nenin 297.1 nën (a) dhe (b) të LPK-së. Gjykata e shkallës së dytë në këtë rast çështjen e plotësimin të kushteve për caktimin e masës së sigurisë, e ka trajtuar në aspektin e ekzistimit të rrezikut për caktimin e masës së propozuar nga paditësi-propozuesi i masës, me vlerësim se propozuesi me asnjë provë dhe asnjë rrethanë nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e ndonjë rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit të propozuar të njëjtit do t'i pamundësohet apo vështirësohet realizimi i kërkesës. Gjykata e Apelit, pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë së përmes masave të sigurimit tentohet që të ruhet gjendja ekzistuese e rrethanave, dhe se pretendimet e ngritura nga propozuesi se anëtarët e komisionit kanë dhënë vlerësime sipas dëshirës së tyre, nuk paraqesin bazë për caktimin e masës së sigurimit ngase nuk është bërë i besueshëm një pretendim i tillë. Caktimi i masës së sigurimit ka për qëllim sigurimin e kërkesës kryesore në rastet kur ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtyllë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës. Ndërsa në rastin konkret nuk ekziston rreziku se propozuesi i sigurimit të realizoj kërkesën e tij po që se pas përfundimit të shqyrtimit kryesor rezulton së kërkesëpadia është e bazuar, duke pasur parasysh edhe faktin së pala kundërshtare është ndërmarrje publike. Andaj, nga këto arsye kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar në mënyrë komulative kushtet për caktimin e masës së sigurimit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 297 paragrafi 1, pika (a) dhe (b) të LPK-së.

Sa i përket pretendimeve se paditësi ka kualifikime, Gjykata e Apelit vlerëson së ky pretendim së bashku me pretendimet tjera që kanë të bëjnë me ligjshmërinë e konkursit, duhet të trajtohet me rastin e vendosjes lidhur me kërkesëpadinë e paditësit. Kjo pasi që gjykata me rastin e vendosjes lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurimit duhet të kufizohet vetëm në vlerësimin e fakteve që kanë të bëjnë me plotësimin e kushteve ligjore nga neni 297.1, pika (a) dhe (b) të LPK-së, e që në rastin konkret ka rezultuar së nuk janë plotësuar këto kushte, pasi që propozuesi i masës së sigurimit nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut, dhe në mungesë të plotësimin të këtij kushti nuk mund të lëshohet masa e sigurimit.

Gjykata e Apelit pa u lëshuar në shpjegime të mëtejme të cilat mund të prejudikojnë vendosjen meritorë për themelësinë e kërkesëpadisë, jep vlerësimin se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, por fakti se me aktvendimin e atakuar është refuzuar masa e sigurimit të kërkesëpadisë nuk nënkupton se vendosja meritorë nuk mund të jetë ndryshe, pasi që vendosja meritorë është rezultat i të gjeturave të gjykatës në shqyrtim kryesor, ku shqyrtohen të gjitha faktet dhe provat për të gjitha kërkesat/pretendimet dhe kundërshtimet.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
CA.nr.3405/2024, datë 22.04.2024

Kryetari i Kolegjit, Gjyqtari
Dardan Kadolli